



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:154415

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05598386

KPPP.nr.1888/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Banka Credins” SH.A., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.O. avokat nga Prishtina, kundër debitorëve 1. “Prishtina e Re” SH.P.K. me seli në Prishtinë Lagjja Veternik, 2. M.B. dhe 3. L.M. nga Prishtina, me adresë në rrugën ”Holger Petersen” pn, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson M.P. dhe F.K., të dy avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.424/20 të datës 08.10.2020, të Përmbartuesit Privat Eset Murati me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 19.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorëve “Prishtina e Re” SH.P.K., M.B. dhe L.M. dhe MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.424/20 i datës 08.10.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Banka Credins” SH.A., në ka lëshuar Urdhri Përmbartimor P.nr.424/20 të datës 08.10.2020, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit noterial, Kontratë Kredie me shenjën Nr.4052 KOL. e datës 24,12,2014 dhe Kontratë Hipoteke me shenjën LRP NR. 7067/2014 e datës 29.12.2014, duke detyruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 348.817,82€, me kamatë ligjore vjetore 8%, nga dita e caktimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet përmbartimore nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm përmes përmbartimit të mjeteve

monetare në llogaritë bankare të debitorit si dhe regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në përmbushjen e kredisë.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim, në të cilin ka kundërshtuar në tërësi Urdhri Përmbarimor P.nr.424/20 të datës 08.10.2020, duke e kontestuar në tërësi borxhin e paraqitur sikurse në propozimin për përmbarim me arsyetimin se dokumenti me të cilin është iniciuar procedura përmbarimore nuk paraqet dokument përmbarimorë si dhe dokumentet në bazë të së cilave është lejuar përmbarimi nuk janë origjinale apo kopje të vërtetuara siç kërkohet me dispozita ligjore. Tutje, ka theksuar se propozimi për përmbarim është bazuar në dokumentin përmbarimorë i cili është në kundërshtim me dispozitat ligjore, kjo për faktin se nuk ka kaluar afati për përmbushjen vullnetare të detyrimit duke iu pamundësuar kështu debitorit përmbushja e detyrimit. Po ashtu, ka kundërshtuar kamatën ligjore prej 8% si të paligjshme duke shtuar edhe se në rastin konkret kemi të bëjmë me përmbarim të dokumenteve të huaja. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorëve dhe të shfuqizohet Urdhri Përmbarimorë P.nr.424/20 të datës 08.10.2020.

Kreditori brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara dhe shtuar se prapësimi nuk është nënshkruar nga debitori i dytë dhe i tretë, vetëm nga i pari dhe se duhet të vazhdoj procedura ekzekutimi ndaj debitorit të dytë dhe të tretë. Tutje ka kundërshtuar prapësimet e parashtruara nga debitori lidhur me dokumentin përmbarues duke theksuar se procedura përmbarimore është iniciuar duke u bazuar në dokumentin e përcaktuar me ligj si titull ekzekutiv. Po ashtu, ka kundërshtuar pretendimin e debitorit për shkelje të dispozitave ligjore lidhur me përmbushjen vullnetare duke theksuar se debitorëve u është dhënë mundësi përmbushja e detyrimit mirëpo nuk janë respektuar afatet e përcaktuara për përmbushje të detyrimit.

Lidhur me këtë rast, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktvendimit PPP.nr.2771/20 të datës 16.07.2021 kishte aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe kishte shfuqizuar Urdhri Përmbarimorë P.nr.424/20 të datës 08.10.2020 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Eset Murati me seli në Prishtinë.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vepruar sipas ankesës së debitorit përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.687/22 kishte anuluar Aktvendimin PPP.nr.2771/20 të datës 16.07.2021, duke aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit si të bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, rekomandimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata shqyrtoi këtë çështje juridike – përmbaremore në përputhje me nenin 190 të LPP-i cili ka përcaktuar se: *“Për të vendosur për propozimin për përmbaremin për sendin e paluajtshëm dhe për zbatimin e aktvendimit për përmbaremin, e kompetencës tokësore është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria.”*, si dhe nenit 13 par 1. Pika 1.2, të Ligjit për Gjykatën Komerciale i cili përcakton se kompetencën e Gjykatës Komerciale: *“1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbaremore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbareues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbaremin vetëm në bazë të dokumentit përmbareues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.3, përcaktohen dokumentet përmbareuese siç janë: *“1.3. dokumenti noterial i përmbareueshëm në pajtim me ligjin për noterinë”*.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbaremin, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbareues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbareuesit privat bazohet në dokumentin përmbareues përkatësisht dokumentit noterial Kontratë Kredie me shenjën Nr.4052 KOL. të datës 24,12,2014 dhe Kontratë Hipoteke me shenjën LRP NR. 7067/2014 të datës 29.12.2014, të cilat janë kopje e vërtetuar tek noteri Julian Zhelegu me Nr.Rep. 5439 të datës 22.09.2020, të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.3 për tu paraqitur si dokument përmbareues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbaremit.

Sipas vlerësimit të gjykatës Kontrata për Hipoteke me shenjën LRP NR. 7067/2014 e datës 29.12.2014 e përpiluar në Republikën e Kosovës pranë zyrës noteriale të noteres Merita Kostanica me seli në Prishtinë, është bazë me të cilin është nxjerr Aktvendimi mbi Regjistrimin

e Hipotekës me Nr.011-954-6-1176 i datës 05.01.2015 i lëshuar nga Zyra Komunale e Kadastrit ne Prishtinë, i cili ndonëse është kopje me të vërtetohet se është siguruar kredia e kreditorit “Banka Credins” me seli ne Tiranë, Republika e Shqipërisë, me të dhënat e të debitorëve “Prishtina e Re” me seli në Veternik Prishtinë, M.B. dhe L.M. nga Prishtina rruga ”Holger Petersen” pn, M.B. rr.”Holger Petersen” Prishtinë, për Parcelat Nr. 1756-1 dhe 1756-2, ky dokument nuk kërkohet të dorëzohet në origjinal përderisa procedura përbarimore nuk është iniciuar mbi bazën e aktvendimit, por mbi bazën e dokumentit noterial - Kontratës për Hipoteke me shenjën LRP NR. 7067/2014 të datës 29.12.2014 e cila është dorëzuar në kopje të vërtetuar nga origjinali pranë zyrës së noterit Julian Zhelegu me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit në prapësim, se dokumentet në bazë të së cilave është lëshuar urdhri përbarimor nuk kanë titull ekzekutiv ose nuk kanë tipare të përbarueshmërisë dhe vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se dokumentet e lartcekura i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të përbarueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përbarim, pasi që në shkresat e lëndës janë bashkangjitur kopjet e noterizuara siç u elaborua më lartë.

Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me përbarimin e dokumenteve të huaja, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i paqëndrueshëm për faktin se nga Kontrata për Hipoteke me shenjën LRP NR. 7067/2014 e datës 29.12.2014 shihet se e njëjta është përpiluar në Republikën e Kosovës pranë zyrës noteriale të noteres Merita Kostanica me seli në Prishtinë, pra që përbën dokument noterial konform LPP-së, si dhe i njëjti përmban klauzolën e përbarueshmërisë.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje përbarimore, andaj nga sa u tha më lartë vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1888/23, datë 19.04.2024.

Numri i lëndës: 2020:154415
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05598386

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.